

# **RREGULLORJA MBI PROCEDURAT PËR PARAQITJEN E NJË KËRKESE, SHQYRTIMIN E SAJ DHE AFATET E NJOFTIMIT KUR KLIENTI DYSHON NË SAKTËSINË E TË DHËNAVE TË APARATIT MATËS TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

## **PJESA E PARË**

### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

##### **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregullore është që të përcaktohen kushtet dhe procedurat për paraqitjen, shqyrtimin dhe zgjidhjen e kërkesave të klientëve në lidhje me saktësinë e të dhënave të aparatit matës të energjisë elektrike si edhe afatet kohore për trajtimin dhe zgjidhjen e këtyre kërkesave.

#### **Neni 2**

##### **Baza ligjore**

Kjo rregullore bazohet në Ligjin 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë elektrike”, Neni 77 Pika 6, “Verifikimi i Matësve”.

#### **Neni 3**

##### **Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje do të jenë kërkesat e Klientëve lidhur me saktësinë e matësit të energjisë elektrike të instaluar nga OSSH tek klienti.

#### **Neni 4**

##### **Fusha e zbatimit**

Kjo rregullore përcakton procedurën e paraqitjes së kërkesës, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit të kërkuarit për rastet kur ai dyshon në saktësinë e matësit të energjisë elektrike në mënyrë që:

1. Të sigurojë trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues ndaj të gjithë klientëve, në respekt të të drejtave dhe detyrimeve të tyre në lidhje me

- saktësinë e matjes së energjisë elektrike të konsumuar prej tyre;
2. Të mbrojnë Klientët përmes promovimit të qasjes transparente ndaj kërkesave që kanë të bëjnë me saktësinë e matjes së energjisë elektrike të rregjistruar nga matësi elektrik të instaluar te klienti,
  3. Të sigurojnë përmbushjen e kriterëve të matjes së energjisë elektrike në mënyrë transparente.
  4. Të garantojnë zhvillimin një procedure të shpejtë dhe transparente për trajtimin e kërkesave të Klientëve nga OSSH
  5. Të garantojnë trajtimin e kërkesave në zbatim të procedurave dhe afateve të zgjidhjes së kërkesave sipas parashikimeve të përcaktuara në këtë Rregullore.
  6. Çdo ankesë që lidhet me elementet e veprës penale dhe vjedhjes së energjisë elektrike, të përcaktuara në Ligjin 43/2015 “Mbi Sektorin e Energjisë Elektrike”, nuk trajtohen në këtë rregullore dhe janë nën juridiksionin e gjykatës kompetente.

## **Neni 5**

### **Referencat**

Referencat ligjore të përdorura në këtë rregullore janë:

- Ligji Nr.43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike",
- Ligji Nr.9875, datë 14/02/2008 “Për Metrologjinë” i ndryshuar,
- Kodi i Matjes ( miratuar nga ERE)
- Kontrata Tip e Shërbimit të verifikimit të matësive të energjisë elektrike dhe vulosjen e tyre(miratuar nga ERE)
- Metodologjia e llogaritjes së dëmit ekonomik (të miratuar nga ERE)
- legjislacionin në fuqi që rregullon përkatësisht marrëdhëniet në Republikën e Shqipërisë.

## **Neni 6**

### **Përkufizime**

Termet e përdorur në këtë rregullore referuar në Ligjin 43/2015 “Mbi Sektorin e Energjisë Elektrike”, dhe Ligjin 9875 “Mbi Metrologjinë”, i ndryshuar, kanë

kuptimin si në vijim:

- **“Enti Rregullator i Energjisë”** ose **“ERE”** është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike, i cili funksionon në përputhje me ligjin Nr. 43 datë 30/04/2015 ”Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.
- **“Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë”** ose **“DPM”** është person juridik, publik, i specializuar për metrologjinë, në varësi të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, dhe që zhvillon aktivitetin në mbështetje të ligjit Nr. 9875, datë 14.02.2008 “Për Metrologjinë”, i ndryshuar si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.
- **“Klient”** është një klient shumice ose fundor i energjisë elektrike.
- **“Klient fundor”** është një klient që blen energji elektrike vetëm për përdorim vetjak.
- **“Klient familjar”** është një klient që blen energji elektrike vetëm për konsumin e tij familjar, pa përfshirë konsumin për veprimtari tregtare apo profesionale.
- **“Klientë jofamiljarë”** janë personat fizikë ose juridikë që blejnë energji elektrike, e cila nuk shkon për përdorim familjar, prodhuesit dhe klientët e shumicës.
- **“Kodi i Matjes”** është tërësia e rregullave teknike dhe normat minimale të detyrueshme për matjen dhe regjistrimin e Energjisë Elektrike, me qëllim matjen dhe regjistrimin e energjisë elektrike.
- **“Matës energjie”**- janë aparate matëse që masin energjinë elektrike nëpërmjet integritit të fuqisë elektrike në lidhje me kohën respektive.
- **“Klasa e saktësisë”** - është klasa e matësit të energjisë elektrike që plotëson kërkesat metrologjike të deklaruara, të cilat kanë për qëllim që të mbajnë gabimet e matjes ose pasiguritë e matjes brenda kufijve të përcaktuara nën kushtet e punës specifike.
- **“Gabimi i matjes”** - është tregimi i matësit minus vlerën e vërtetë.
- **“Gabimi relativ”** - është ai që rezulton nga formula e mëposhtme:  
Gabimi në përqindje =  $(\text{energji i regjistruar} - \text{vlerën e vërtetë}) \times 100 / \text{vlerën e vërtetë}$ .
- **“Gabimi maksimal i lejuar”** – “GML” është vlera më e madhe e gabimit të matjes, në përputhje me një vlerë referencë të njohur, e cila lejohet nga specifikimet ose standardet për një instrument matës apo sistem matjeje.
- **“Verifikim”**- është konfirmimi nëpërmjet ekzaminimit dhe evidentimit, nëse janë plotësuar kërkesat specifike, tekniko-metrologjike.

- **“Autorizim”** - është dhënia e së drejtës për të kryer shërbime të metrologjisë ligjore të instrumenteve matëse në sferën e detyrueshme, subjekteve publike dhe private, vendase ose të huaja, që kryejnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.
- **“Subjekti i Autorizuar”** është subjekti i autorizuar nga DPM për të kryer shërbimin e verifikimit dhe të vulosjes së matësit elektrik.

## **PJESA E DYTË**

### **ANKESAT E KLIENTËVE PËR SAKTËSINË E MATËSIT TË ENERGIJISË ELEKTRIKE**

#### **Neni 7**

#### **Kërkesat për saktësinë e matësit elektrik**

1. Nëse klienti dyshon në saktësinë e matësit elektrik në përdorim të tij , ai paraqet një kërkesë, pranë zyrave të OSSH si dhe çdo institucioni tjetër përgjegjës, për verifikimin e aparatit matës, duke plotësuar formularin e kërkesës, bashkangjitur kësaj Rregulloreje (Aneksi 1).
2. Në rastet kur klienti paraqet një kërkesë për verifikim të saktësisë të aparatit matës të energjisë elektrike pranë institucioneve të tjera përgjegjëse, ato do të rregjistrojnë kërkesën e tij dhe do t’ia përcjellin OSSH në zbatim të afateve kohore për trajtimin e kërkesave.
3. Në të gjitha rastet, institucioni përgjegjës, të cilit i është drejtuar kërkesa e klientit për verifikim të saktësisë të aparatit matës të energjisë elektrike, do të vërë në dijeni dhe klientin për përcjelljen e kërkesës së tij pranë OSSH.
4. Me paraqitjen e kërkesës, përfaqësuesi i OSSH është i detyruar të rregjistrojë kërkesën dhe të pajisë klientin me një numër unik të kërkesës së paraqitur.
5. OSSH planifikon shërbimin e inspektimit dhe testimit të matësit elektrik tek klienti jo më vonë së 3 ditë pune prej ditës së paraqitjes së kërkesës..
6. OSSH njofton klientin për ditën dhe orën kur parashikohet të kryhet inspektimi dhe testimi i matësit tek klienti.
7. OSSH planifikon kryerjen e shërbimit duke njoftuar subjektin e autorizuar nga DPM për verifikimin e matësive elektrike që mbulon zonën administrative të klientit që ka paraqitur kërkesën. Nëse matësi elektrik ka qënë i verifikuar më parë

nga një subjekti i autorizuar që mbulon zonën administrative të klientit që ka paraqitur kërkesën, OSSH njofton një subjekt të autorizuar që kryen aktivitetet në një zonë tjetër administrative që të kryejë këtë shërbim.

8. OSSH dhe subjekti i autorizuar kryejnë shërbimin e inspektimit dhe verifikimit të matësit elektrik për saktësinë e të cilit është ankuar klienti. Verifikimi i saktësisë do të kryhet në prezencën e OSSH, subjektit të autorizuar për verifikimin e matësive elektrike si edhe në prezencë të klientit që ka paraqitur kërkesën.

9. Shërbimi i verifikimit të matësit tek klienti do të kryhet pa e shkëputur matësin elektrik nga lidhjet elektrike. Rregjime të ndryshme ngarkese do të realizohen ose nëpërmjet vetë klientit ose duke realizuar ngarkesa të ndryshme në vend nga subjekti i autorizuar.

10. Nëse gjatë verifikimit në terren subjekti i autorizuar nuk është në gjendje të gjykojë mbi saktësinë e matësit të energjisë elektrike, atëherë ai kërkon që aparati matës të testohet në kushte laborator. Kjo kërkesë dëshmohet duke vendosur nga ana e tij etiketa sigurie Ri-Testim në Laborator.

11. Me përfundimin e inspektimit përgatitet raporti i testimit i cili firmoset nga përfaqësuesi i OSSH dhe përfaqësuesi i subjektit të autorizuar. Një kopje e raportit të testimit i dorëzohet edhe klientit që ka paraqitur kërkesën.

12. Nëse aparati matës i konstatuar i dëmtuar do t'i nënshtrohet procesit të riparimit OSSH, njofton më parë Klientin për këtë, duke i bërë me dije këtë të fundit afatet brenda të cilave mund të kërkojë të ushtrojë të drejtën për të kërkuar ritestim të aparatit pranë një tjetër subjekti të autorizuar nga DPM.

13. Nëse gjatë inspektimit dhe verifikimit të matësit elektrik, identifikohen parregullsi apo ndërhyrje të paautorizuara në sistemin e matjes, që ndikojnë në rregjistrimin e konsumit të energjisë elektrike dhe nuk përbëjnë vepër penale, OSSH do të faturojë dëmin ekonomik sipas metodologjisë së llogaritjes së dëmit të miratuar nga ERE.

## Neni 8

### Interpretimi i rezultateve të verifikimit të Kërkesës mbi saktësinë e matësit elektrik

1. Kur pas verifikimit nga subjekti i autorizuar në prani të përfaqësuesit të OSSH dhe klientit që ka paraqitur kërkesën, konstatohet se gabimi i matjes i regjistruar pas testimit është përtej gabimit maksimal të lejuar dhe nuk ka prova të dëmtimeve me dashje të bëra nga klienti, atëherë OSSH kryen përlogaritjet përkatëse të sasisë së energjisë së faturuar më shumë ose më pak, sipas rezultatit të pasaktësisë në matës dhe në këtë mënyrë bëhet rimbursimi sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në Kodin e Matjes.
2. Rregullimet për pasaktësitë e matjeve do të kufizohen për periudhën e fundit 12 mujore
3. Kur konstatohet nga subjektet e autorizuar për kryerjen e testimit të matësave elektrik, që matësi i kalon kufijtë e saktësisë të përcaktuara (minus ose plus), atëherë do të aplikohet procedura e kompensimit e mëposhtme:
  - a. Në rastin kur kemi rezultate që vërtetojnë se matësi nuk bënë matje të saktë të energjisë elektrike dhe gabimi i matjes i kalon kufijtë e përcaktuar në kontratën tip mbi verifikimin e matësave të energjisë elektrike dhe vulosjen e tyre dhe klienti ka paguar më pak (gabimi i testimit është negativ), atëherë klienti është i detyruar të paguajë diferencën e vlerës midis gabimit të matjes dhe tolerancës së gabimit maksimal të lejuar për 12 muaj të mëparshëm duke filluar prej ditës kur është bërë verifikimi ose për periudhën midis dy verifikimeve, nëse ka më shumë se një verifikim të saktësisë se aparatit mates brenda 12 muajve.
  - b. Në rastin kur kemi rezultate që vërtetojnë se matësi nuk bënë matje të saktë të energjisë elektrike dhe gabimi i kalon kufijtë e përcaktuar në kontratën tip mbi verifikimin e matësave të energjisë elektrike dhe vulosjen e tyre dhe klienti ka paguar më shumë (gabimi i testimit është pozitiv), atëherë OSSH është i detyruar të kompensojë diferencën e vlerës midis gabimit të matjes dhe tolerancës së gabimit maksimal të lejuar për 12 muaj të mëparshëm duke filluar prej ditës kur është bërë verifikimi ose për periudhën midis dy verifikimeve, nëse ka më shumë se një verifikim të saktësisë se aparatit mates brenda 12 muajve..

4. Nëse testimi për qëllime verifikimi është kryer në kushte laborator, si pikë referuese për vlerësimin e kompensimit do të shërbejë diferenca midis gabimit të matjes që rezulton në matës pas testimit dhe gabimit maksimal të lejuar sipas klasës së saktësisë së vetë matësit elektrik. Gabimi i matjes së matësit llogaritet në pikën referuese të ngarkesës si më poshtë:

a. Matësa 1(një) fazorë : Ngarkesa simetrike nominale(bazë),  $I=100\%$ , për  $\cos\phi=1$

b. Matësa 3(tre) fazorë : Ngarkesa simetrike nominale(bazë),  $I=100\%$  (L1,L2,L3) për  $\cos\phi=1$

5. Nëse testimi për qëllime verifikimi është kryer në kushte terreni me instrumenta etalon referues portative, si pikë referuese për vlerësimin e kompensimit do të shërbejë diferenca midis gabimit të matjes që rezulton në matës pas testimit me 1.5 x klasën e matësit elektrik.

6. Matësi që rezulton i rregullt, pas verifikimit do të vuloset me vulë sigurie dhe një çift etiketash sigurie. Matësi që rezulton jo i rregullt do të identifikohet me anën e një çift etiketash sigurie që tregon se matësi është jo i rregullt. OSSH do të kryejë zëvendësimin e këtij matësi që rezulton jo i rregullt brenda tre ditë pune prej ditës së testimit nga subjekti i autorizuar.

## **PJESA E TRETË**

### **Neni 9**

#### **Detyrimet financiare**

1. Kur verifikimi i matësit është bërë me kërkesë të klientit dhe gjatë verifikimit të matësit nuk konstatohen pasaktësi, atëherë shpenzimet e verifikimit paguhen nga klienti që ka paraqitur kërkesën.

2. Tarifat tavan për verifikimin e matësve miratohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit përgjegjës për energjinë, sikurse përcaktohet në Ligjin Nr.43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike".

## **PJESA E KATËRT**

### **Neni 10**

#### **Afati i realizimit të shërbimeve**

1. Realizimi i shërbimit të inspektimit dhe të verifikimit të matësit elektrik të klientit që ka bërë kërkesë pranë OSSH, kryet brenda 3 ditëve pune prej ditës së paraqitjes së kërkesës në zyrat e Kujdesit ndaj Klientit të OSSHE.
2. Brenda 3 ditëve pune prej ditës së kryerjes së shërbimit të verifikimit të matësit elektrik, OSSH paraqet vlerësimin ndaj kërkesës së bërë dhe ia dorëzon klientit.

## **PJESA E PESTË**

### **Neni 11**

#### **Dhënia e informacionit**

1. OSSH do të paraqesë informacion mujor në ERE në lidhje me kërkesat e klientëve për saktësinë e matësit elektrik.
2. Forma e informimit do të jetë sipas formularit paraqitur në Aneks 2.

## **PJESA E GJASHTË**

### **Neni 12**

#### **Apelimi i kërkesës**

1. Në rastet kur klienti nuk është i kënaqur me trajtimin e kërkesës nga OSSH apo kur klienti nuk është dakort me vlerësimin e bërë nga OSSH pas verifikimit të matësit elektrik, atëhere klienti paraqet në ERE ankimin mbi trajtimin e kërkesës që lidhet me saktësinë e matësit elektrik, nga OSSH .
2. Sektori i Mbrojtjes së Konsumatorit në ERE është përgjegjës për administrimin e kërkesave në formë apelimi



3. ERE i kërkon palëve dorëzimin e të gjithë dokumentacionit që lidhet me kërkesën, raportin e verifikimit të matësit elektrik nga subjekti i autorizuar, raportin e inspektimit të kryer nga operatorët e OSSH si dhe çdo informacion tjetër që mund ti shërbejë shqyrtimit të kërkesës nga ERE.
4. ERE mund të organizojë seance dëgjimore për tu njohur me shpjegimet e palëve. ERE mund të kërkojë ekspertizë shtesë nga DPM ose subjekte të tjera për vlerësimin e kërkesës.
5. ERE siguron se të gjitha palët në hetimin e çelur nga ERE për trajtimin e kërkesës, do të trajtohen njësoj dhe me mundësi të barabarta për të parashtruar argumentet e tyre.
6. Në rrethana specifike dhe vetëm nga nevoja për të parandaluar ndonjë dëmtim të pakthyeshëm apo dëm kundrejt interesave të palëve, me kërkesë të palës ankuese, ERE mund të nxjerrë ndonjë masë të përkohshme që e konsideron të përshtatshme. Këto masa të përkohshme janë vendime tranzitore, në formën e masës së sigurisë, që nevojiten për të mbrojtur ankuesin ose furnizuesin.

### **Neni 13**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ANEKSI 1**  
**FORMULARI I PREZANTIMIT TË KËRKESËS OSE ANKESËS**

Nr serie:

Data:

Instanca:

**TË DHËNAT PERSONALE OSE TË KOMPANISË**

Emri		Adresa	
Atësia		Lagja	
Mbiemri		Emërtimi i Shoqërisë	
Datëlindja		NIPT	
Nr i Dokumentit të Identifikimit		Nr Telefoni	
Lloji i Dokumentit		Email	
Ankimuesi			

**INFORMACIONI I ANKESËS**

Kodi i Klientit		Tipi i Kontratës	
Kabina		Numri i Serisë së Faturës	
KNK Pritëse		KNK Trajtuese	

**INFORMACION MBI MATËSIN ELEKTRIK**

Uzina		Tensioni (V)	
Modeli		Rryma (A)	
Viti i Prodhimit		Nr Impulseve (rrot-imp/kWh-kVArh)	
Nr Serial		Nr Fazëve	
Tipi i Matësit		Klasa e saktësisë	

**INFORMACION MBI VERIFIKIMIN E MATËSIT ELEKTRIK**

Verifikim i kryer nga		Vula e morseterisë së Kompanisë testuese	
Vula e makinerisë		Vula e morseterisë së OSHEE	
Etiketa e makinerisë			

**PËRSHKRIMI I ANKESËS**

Ankesë në lidhje me faturimin

---

Ankesë në lidhje me saktësinë e matësit elektrik

---

**JU LUTEMI SHËNONI ADRESËN KU DESHIRONI T'JU VIJË PËRGJIGJA E ANKESËS**

Përmes Postës

Përmes SMS

Përmes E-mailit

**SHËNIME (PËRSHKRIM I SHKURTER I KËRKESËS OSE ANKESËS)**


Nëpërmjet nënshkrimit tim pranoj se, nëse nuk kam dhënë informacion të saktë ANKESA/KËRKESA do të shtyhet ose refuzohet deri në dorëzimin e informacionit të plotë. Gjithashtu autorizoj shoqërinë OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SH.A për përdorimin e të dhënave të mia personale për njoftime që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimit të furnizimit me energji elektrike në përputhje me detyrimet që burojnë nga kontrata e furnizimit me energji elektrike.

**Punonjësi**

Emër / Mbiemër / Firmë

**Abonenti**

Emër / Mbiemër / Firmë